

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën zgjedhore mësimore **Pedagogjia për vitin III (e tretë) të arsimit të mesëm - gjimnaz** për vitin shkollor 2020/2021.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM MËSIMOR I SHKURTUAR NGA LËNDA

PEDAGOGJIA

PËR VITIN E III (TRETË)

Fusha zgjedhore: gjuhësore – artistike

shoqërore – humanistike

Shkup, shtator 2020

1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar, i lëndës zgjedhore **Pedagogjia për vitin III (e tretë)**, në arsimin e mesëm – gjimnaz, bazohet në qëllimet konkrete parashikuara në programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet sipas planit mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, gjatë së cilës konsiderohet fondi i paraparë javor i orëve të përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht për një lëndë mësimore me fond javor prej 2 orë, në programin e shkurtuar parashikohen 64 orë mësimore.

Mësuesi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar, drejtohet kah qëllimet/rezultatet e parashikuara, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

Programi mësimor i shkurtuar i lëndës mësimore **Pedagogjia për vitin e III** në arsimin e mesëm - gjimnaz, realizohet në vitin shkollor 2020/2021.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I TEMAVE DHE NJËSIVE MËSIMORE

TËRËSIA TEMATIKE: SHOQËRIA DHE ARSIMI (8 ORË)

Njësitë mësimore:

1. Edukimi si pasojë dhe nevojë e zhvillimit shoqëror
2. Edukimi si një veprimtari shoqërore e ndërgjegjshme, e përshtatshme dhe e organizuar
3. Kushtëzimi shoqëroro – historik i edukimit
4. Edukimi në shoqërinë gjinore
5. Edukimi në shoqërinë skllavopronare
6. Edukimi në shoqërinë feudale
7. Edukimi në shoqërinë qytetare
8. Edukimi dhe arsimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut

TËRËSIA TEMATIKE: PEDAGOGJIA DHE NOCIONET THEMELORE PEDAGOGJIKE (15 ORË)

Njësitë mësimore:

1. Pedagogjia si shkencë e edukimit
2. Zhvillimi i teorisë dhe praktikës pedagogjike
3. Raporti i pedagogjisë me filozofinë dhe psikologjinë
4. Raporti i pedagogjisë me sociologjinë dhe antropologjinë
5. Raporti i pedagogjisë me kibernetikën dhe ekologjinë
6. Pedagogjia e përgjithshme dhe historia e pedagogjisë
7. Didaktika dhe metodika e mësimdhënies
8. Pedagogjia parashkolllore dhe pedagogjia shkolllore
9. Pedagogjia familjare dhe pedagogjia e kohës së lirë
10. Andragogjia dhe pedagogjia industriale
11. Pedagogjia speciale
12. Pedagogjia e konvikteve
13. Metodologjia dhe pedagogjia

- | |
|---|
| 14. Konceptet themelore pedagogjike
15. Ushtrime |
|---|

TËRËSIA TEMATIKE: FAKTORËT E ZHVILLIMIT TË PERSONALITETIT (10 ORË)

Njësitë mësimore:

- | |
|---|
| 1. Faktorët trashëgues
2. Faktorët social
3. Pasojat pedagogjike
4. Faktorët vendimtar në zhvillimin e personalitetit
5. Trashëgimia
6. Mjedisi shoqëror
7. Edukimi
8. Aktiviteti i personalitetit
9. Lidhshmëria e faktorëve vendimtar
10. Ushtrime |
|---|

TËRËSIA TEMATIKE: NXËNËSI DHE EDUKATORI (5 ORË)

Njësitë mësimore:

- | |
|--|
| 1. Nocioni <i>nxënës</i>
2. Karakteristikat themelore të zhvillimit të nxënësve
3. Nxënësi si objekt dhe subjekt
4. Nocioni <i>edukator</i>
5. Thirrja e edukatorit dhe mësuesit |
|--|

TËRËSIA TEMATIKE: EDUKIMI FAMILJAR (5 ORË)

Njësitë mësimore:

- | |
|--|
| 1. Familja si faktor themelor dhe i pazëvendësueshëm |
|--|

- | |
|---|
| <ol style="list-style-type: none">2. Përkufizimi i nocionit <i>familje</i>3. Karakteristikat e familjes4. Kushtet themelore të familjes për një zhvillim pozitiv të fëmijëve5. Bashkëpunimi i familjes me shkollën |
|---|

TËRËSIA TEMATIKE: SISTEMI SHKOLLOR (4 ORË)

Njësitë mësimore:

- | |
|---|
| <ol style="list-style-type: none">1. Karakteristikat dhe struktura e sistemit shkollor2. Edukimi parashkollor3. Edukimi dhe arsimi fillor4. Arsimi i mesëm dhe i lartë |
|---|

TËRËSIA TEMATIKE: KOMUNIKIMI (5 ORË)

Njësitë mësimore:

- | |
|---|
| <ol style="list-style-type: none">1. Çfarë është komunikimi?2. Elementet e komunikimit3. Llojet e komunikimit4. Thelbi dhe kuptimi i komunikimit5. Funksionet e komunikimit |
|---|

TËRËSIA TEMATIKE: PARIMET BASHKËKOHORE TË EDUKIMIT (7 ORË)

Njësitë mësimore:

- | |
|--|
| <ol style="list-style-type: none">1. Edukimi për paqe2. Edukimi për të pranuar dhe kuptuar ndryshimet midis njerëzve3. Edukimi për mjedis të pastër4. Edukimi interkulturore dhe multikulturore5. Filmi dhe diskutim rreth edukimit multikulturore |
|--|

- | |
|---|
| 6. Edukimi gjinor
7. Punëtori me temë: Respekt ndaj anëtarëve të gjinisë së kundërt, apo tema të tjera në sugjerim të nxënësve |
|---|

TËRËSIA TEMATIKE: PEDAGOGJIA E KOHËS SË LIRË (5 ORË)

Njësitë mësimore:

- | |
|--|
| 1. Koha e lirë si kategori ekonomike, sociale dhe edukative
2. Definimi i kohës së lirë
3. Përmbajtja dhe dizajni i kohës së lirë
4. Aktivitetet e lira të nxënësve
5. Të rinjtë dhe koha e lirë |
|--|

3. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

Pika fillestare për realizimin e programit mësimor të shkurtuar të lëndës mësimore **Pedagogjia**, është programi mësimor i rregullt që bazohet në qëllimet konkrete, udhëzimet didaktike, korrelacioni midis tërësive tematike, sipas planit të përcaktuar mësimor. Gjatë realizimit të këtij programi të shkurtuar mësimor, mësuesi do t'i përdorë paranjohuritë e nxënësve nga lëndët mësimore: histori, sociologji, psikologji etj. Për çdo tëresi tematike, është dhënë numri i përgjithshëm i orëve që duhet të realizohen.

Njësitë mësimore nga programi i shkurtuar mësimor, nga lënda mësimore Pedagogji, realizohen në orë mësimore me kohëzgjatje të shkurtuar prej 35 minutash. Gjatë realizimit të orës në të cilën përpunohet përmbajtje e re mësimore, ora duhet të përbëhet nga pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe pjesa përfundimtare.

Pjesa hyrëse duhet të zgjasë 5 minuta. Në këtë pjesë të orës, nëpërmjet pyetjeve dhe përdorimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të punës, nxënësit rikujtohen në dituritë e përvetësuara më parë të cilët janë bazë për plotësimin me dituri të reja nga përmbajtja që do të përpunohet gjatë orës. Në këtë mënyrë, mësuesi në të njejtën kohë i kontrollon dhe njohuritë e nxënësve. Gjithashtu,

në pjesë hyrëse, duke përdorur stuhi idesh apo ndonjë teknikë tjetër punuese, mësuesi do të mund të nxisë të menduarit e nxënësve dhe interesimin e motivimin drejt realizimit të qëllimeve të parashtruara për orën aktuale (psh. në hyrje mësuesi mund të prezantojë disa fotografi nga pedagogë të shquar, shkolla nga koha e Komenskit, mund të lexojë mendim nga pedagog të shquar, inçizim nga kopshti, shkolla etj.). Ndonjëherë, mund të parashtrohet edhe situatë problematike e cila do të jetë hyrje e mirë në pjesën kryesore të orës. Situata problematike mund të jetë e dhënë edhe më parë si detyrë shtëpie, me qëllim që nxënësit të kenë kohë të mjaftueshme të mendojnë dhe të jenë të përgatitur ti shkëmbejnë sqarimet e tyre, zgjedhjet, idetë, argumentet, qëndrimet etj. gjatë kohës së pjesës hyrëse të orës.

Në pjesën kryesore të orës, e cila zgjat më së shumti 25 minuta, në të cilën përpunohet përmbajtje e re mësimore, mësuesi i realizon qëllimet e planifikuara, rezultatet e pritura dhe nocionet me metoda dhe aktivitete të përshtatshme. Duke marrë parasysh atë për të cilën flitet, për lëndën mësimore që i takon grupit të shkencave shoqërore, mësuesi më së shpeshti do të përdorë metoda dhe aktivitete të ndryshme të punës si psh: diskutime, prezantime, demonstrime, ilustrime, vëzhgime, punëtori, shpjegime, sqarime, punimi i eseve dhe ngjashëm. Gjatë mësimit të përmbajtjeve të reja mësimore nga distanca, mësuesi do të t'i punojë sa më shumë që të jetë e mundur nëpërmjet mësimit interaktiv. Domethënë, mësuesi duhet të realizojë interaksion me nxënësit dhe t'i kyçë në orë nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve, diskutimeve etj. Gjatë përpunimit të përmbajtjes së re mësimore nëpërmjet mësimit nga distanca, është e domosdoshme që mësuesi të sqarojë dhe të shkruajë në tabelë apo të ketë përgatitur prezantime, e cila gjithashtu duhet të shoqërohet me një shpjegim verbal. Kështu që, dukshmëria duhet të jetë e qartë, e shikueshme dhe e plotë për nxënësit. Përceç prezantimeve, mund të përdoren edhe përmbajtje tjera elektronike (e-përmbajtje) të cilët mësuesi i përgatit vetë, apo shfrytëzon e-përmbajtje të përgatitura që janë në dispozicion të platformës (animacione, simulacione, video, audio, ilustrime, tekste etj.). E-përmbajtjet të cilët mësuesi i përpunon apo i zgjedh duhet të jenë multimediale, respektivisht të kenë tekst, animacione, tinguj, prezantim dhe të jenë në dispozicion për mësim në distancë. E-përmbajtjet përdoren me qëllim që të nxitet interesimi i nxënësve për lëndën mësimore, përmbajtja të kuptohet më lehtë, si dhe të zbatohet njohuria e përvetësuar. Gjatë kohës së orës, me rëndësi është që nxënësit të udhëzohen që të mbajnë evidencë me shkrim për atë që punohet gjatë orës, të jenë aktiv dhe pjesëmarrës në orë, respektivisht, të mbahet interesimi i tyre nëpërmjet interaktivitetit dhe mundësisë të parashtrojnë pyetje, të kenë qëndrimet e tyre, t'i argumentojnë qëndrimet dhe mendimet e tyre etj. Mësuesi gjithmonë të jetë i hapur për bashkëpunim me nxënësit, të jepë informatë kthyesë të përgjigjeve, mendimeve, kreacioneve të nxënësve dhe të përgjigjet pyetjeve që i parashtrojnë nxënësit.

Mësuesi mund të përgatisë edhe chek-lista për të evidentuar përparimin e nxënësit, chek-lista për vetvlerësim. Në pjesën përfundimtare të orës, bëhet një përmbledhje e shkurtër dhe përcaktimi i njohurive të reja që janë përvetësuar gjatë orës, ndërsa është e dëshirueshme që të ketë sllajd i veçantë nga prezantimi në të cilën rezimeja do të jetë e *dukshme*, e rregulluar taksonomikisht apo e rregulluar sipas parimit të rëndësisë hierarkike. Gjithashtu, mund të jepet detyrë shtëpie, jepet sërish mundësi që nxënësit të parashtrojnë pyetje, të shprehin atë që ishte interesant dhe sfidë gjatë orës, si dhe mund të jepen udhëzime dhe sqarime plotësuese në qoftë se është e nevojshme.

Përveç orëve për përpunimin e përmbajtjeve të reja mësimore, sipas programit mësimor, mësuesi duhet të planifikojë, organizojë dhe realizojë dhe orë për përsëritje, ushtrime, kontrollim i njohurive të nxënësve, sistematizim etj. Këto orë duhet të jenë të planifikuara mirë dhe të paramenduara për mësimin nga distanca. Në orët e ushtrimeve duhet të sqarohen dhe të thellohen shembujt e punuara për përvetësimin e njohurive të reja dhe të zgjerohen me shembuj në të cilën nxënësit do të zbatojnë njohurinë e përvetësuar në situata të reja, nëpërmjet zgjidhjes së situatave problematike, gjatë së cilës nxënësit i aktivizojnë proceset kognitive, zbatimi, analiza, vlerësimi dhe sinteza. Kjo mund të realizohet nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve me gojë, diskutimeve, debateve etj. Në këtë mënyrë, nëpërmjet këtyre orëve do të nxitet formimi i njohurive konceptuale tek nxënësit, dmth njohuri që bazohen në të menduarit dhe të kuptuarit, nxënësi do të mësojë si të mendojë, si të mësojë, dhe në të njëjtën kohë do të zhvillojë kompetenca bashkëkohore: dituri, aftësi, qëndrime dhe vlera.

Nëse zbatohet modeli i kombinuar i mësimdhënies, gjatë realizimit të orëve mësimore nga lënda Pedagogji, me prezencë fizike të nxënësve në klasë, është e domosdoshme të respektohen protokolet për distancë fizike dhe mbrojtje personale.

4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën zgjedhore **Pedagogjia** për **vitin III (e tretë)** të arsimit të mesëm – gjimnaz, e miratoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska